

THANAS FEKA

**PASURIA FRAZELOGJIKE NË KRIJIMTARINË
LETRARE TË MARTIN CAMAJ**

Pasuria gjuhësore e shqipes në të gjitha dherat ku ajo gjallon, do të mbetej për Martin Camajn trashëgimia më e vyer, prandaj edhe në poezinë “Trashigimi” shprehet: *Katundi arbëresh kaluer / mbi qafën e bjeshkës / ... Dheu më vren me syrin e plakës / njëqindvjeçare. / “Nanëmadhe, po shkon :/ çka don me vete të merrsh / në kodrinë, nën qeparisa?” / “Hijen e tire bir!” / ...tri fjalë më la tezja arbëreshe / te dheu i eshtnave tonë. / Fjalët e gjuhës seme – një / udhtimë e gjatë në kohë, / një ushtimë e gjatë, e gjatë ndër vesh”¹.*

Dhe te “fjalët e gjuhës seme” ai sheh edhe frazeologjitë e shumta të bukura të shqipes, të cilat, si njësi tipike të ligjërit me vlera të dyfishta: semantike dhe mbishtresore, me një ngjyrim të theksuar emocional, i vlejnë veçanërisht si një lëndë gjuhësore e pazëvendësueshme për krijimtarinë e vet letrare.

Martin Camaj jo vetëm trashëgon e njeh thellë këtë pasuri frazeologjike, por dallohet edhe si mjeshtër i përdorimit të saj. Këtë pohim e mbështet vetë lënda e gjerë frazeologjike e vjelë nga veprat e shkruara në prozë dhe poezi. Më konkretisht, nga proza e tij është veçuar dhe është vjelë shterueshëm romani “Rrathët”², kurse nga krijimtaria poetike janë vjelë po në mënyrë shteruese të gjitha poezitë e përfshira në tri vëllime të botimit me titull “Vepra letrare”³.

Si paraqitet pasuria frazeologjike në këto vepra? Në 317 faqet e romanit “Rrathët” janë përdorur prej autorit 657 njësi frazeologjike, pra mbi dy frazeologji për faqe, një tregues i lartë përdorimi, kurse në 374 faqe me poezi të botuara në tri vëllime⁴, dalin 94 njësi frazeologjike, një shifër

¹ Martin Camaj, Vepra letrare 2, Tiranë 1996, f. 88.

² Martin Camaj, Rrathët, Mynih, 1978.

³ Martin Camaj, Vepra letrare 1,2,3, Tiranë 1996.

⁴ Vëllimet 1 dhe 3 përmbajnë krijime në prozë dhe në poezi, ndërsa vëllimi 2 përfshin vetëm poezi; tri vëllimet me 784 faqe gjithsej, poezia përbën 374 faqe, duke mos përfshirë pjesën me poezi të romanit “Djella”, i shkruar në prozë e poezi.

jo e vogël edhe kjo, po të llogaritet vendi që zë teksti i poezisë në faqen e një libri në raport me atë të prozës dhe aq më tepër po të shtojmë këtu se, për vetë natyrën e këtyre dy gjinive letrare, frazeologjia në poezi është më pak e pranishme në raport me prozën dhe më tej akoma, po të kihet parasysh natyra e poezisë së tij: e shkurtër, e thukët e me reticencë.

Njësitë frazeologjike të përdorura nga autori në këto vepra dallohen edhe për një larmi të madhe tipash semantiko-strukturorë, prandaj po ndalemi shkurt më konkretisht në tre grupet më të mëdha, që na ofron lënda frazeologjike e vjelë, për të parë shkallën e përdorimit të këtyre njësive frazeologjike nga autori për secilin grup, si dhe për të nënvizuar ndonjë veçori të përdorimit të këtyre njësive frazeologjike për ndonjë grup të caktuar ose në përgjithësi.

Nga 751 njësi frazeologjike të përdorura në veprat e vjela në prozë e në poezi, të përmendura më lart, 554 njësi ose afër 74% janë frazeologji foljore, të cilat përbëjnë kështu edhe grupin më të madh. Ky përdorim kaq i shpeshtë i njësive të tilla frazeologjike vjen për dy arsye: së pari, për arsyen e thjeshtë objektive se prania e veprimit a gjendjes në fjali, e shprehur nga folja, është kurdoherë e nevojshme, sepse ai përfaqëson gjymtyrën ndërtuese kryesore më të domosdoshme, kallëzuesin, e shprehur në këtë rast me një frazeologji foljore, por jo pak edhe për një arsye të dytë subjektive: prirjen e dukshme të Martin Camajit për të përdorur, jo rrallë, për shumë folje, gjegjësen frazeologjike të saj, tek e cila ka një shënues jo të drejtpërdrejtë të veprimit, me një kuptim që ka në bazën e vet një thelb metaforik të përfutur nëpërmjet metaforës, dhe, si e tillë, me fuqi shprehëse të veçantë.

Për këtë grup mund të përmendim një varg të gjatë njësish frazeologjike, por këtu po japim për ilustrim disa njësi që në pjesën më të madhe të tyre i përkasin arealit të gegërishtes veriperëndimore, si: **i theku kambët** vrapoi shumë shpejt, **nuk ndërron hapin** nuk ecën, **i shkon për piri** ashtu vepron gjithmonë, e ka zakon, e ka në gjak, **i jap maje** (diçkaje) e zgjidh, i jap udhë, **i ra në ujë fjala** nuk e dëgjoi kush, **e laj me sy** e shoh me vëmendje e imtësi diçka për të dalluar a kapur atë që më intereson, **luaj arushë** (me dikë) tallem me dikë, **i vë shej** (diçkaje) e veçoj dhe i vë mend për ta pasur parasysh, **vë gojë** (mbi dikë) e përgoj, **përzihet në vete** vihet në një gjendje të vështirë, sikletoset, **i kërcejnë rrebet** inatoset, zemërohet keqas, i hipin xhindet, **e marr për hiri** (dikë) e dua, e pëlqej, më hyn në zemër, **i jap mund kresë** e lodh kokën shumë, **i bie moh** e mohoj, **e vë në rrotë** (dikë) e tall, **qet në gjuhë** i jep shkasë dhe e bën të flasë, **bjen fashë** fashitet, qetësohet, **i dalin rrajët** (diçkaje) del në shesh burimi i diçkaje (zakonisht në kuptimin keqësues), **baj pleqni** e shqyrtoj mirë me dikë një

punë a një çështje, e pleqnoj, **i kanë ra trutë në qafë** është matufosur, **e ndaj me gisht nga shokët** e veçoj (e përdorur me një nuancë keqësuese), **më shtjerret (më prishet) zani** ngjirem, më zihet zëri, **e kam në hundë** (dikë) s'e shoh dot me sy, më është neveritur, **s'i di shteg vetes** nuk gjen dot ndonjë rrugëzgjdhje; s'di si të veprojë, është në mëdyshje, **ia za kryet** (dikujt) bëj që të ndihet keq a në vështirësi, e vë në hall etj., e sikletos, **i bie në fjalë** (dikujt) ia ndërpres dikujt fjalën e flas për diçka tjetër për ta ndërruar bisedën, **e ka lëshue zemra** është dëshpëruar shumë; nuk e mban më veten etj.

Për nga ndërtimi paraqesin një larmi strukturash, që nga togjet e qëndrueshme dygjymtyrëshe e deri tek ato shumëgjymtyrëshe, nga ndërtimet në trajtë fjalie e deri në ato struktura që janë afër fjalëve të urta, si: **e vë në beh** bën që të jetë i vëmendshëm e i parapërgatitur që mendon se mund t'i ndodhë, **ta lidh fjalën në fyt** të pengon të flasësh, **shtie veshtë në lesh** nuk do të dëgjojë, **ngreh një gjysmë veshi** përpiket të ndjekë se çfarë flitet pa u dhënë të tjerëve të kuptojnë se po e dëgjon bisedën, **i shkonin djersët për lug të shpinës herë të ngrohta herë të ftohta** ishte në gjendje shumë të vështirë, **atje ku çel dreqi zogj** në një vend shumë të largët, në fund të botës, **mushkës i duhen drutë shkurt** ashtu siç duhet, pa dredha, hapur (si një variant formal më eksplisit në përçimin e përmbajtjes në krahasim me trajtën e njohur *ashtu i do mushka drutë*) etj.

Nga materiali i vjelë del se togjet frazeologjike dygjymtyrëshe janë më të shumta në krahasim me strukturat e tjera. Si në mbarë shqipen e folur dhe të shkruar, mbizotërojnë strukturat dygjymtyrëshe me folje dhe emër e brenda tyre shumicën e përbëjnë njësitë e ndërtuara me folje që kanë një kuptim të përgjithshëm me një përdorim shumë të shpeshtë në gjuhë, si: *bëj, marr, jap, vë, zë, bie, hap, mbyll, çel, çoj, lëshoj, hedh, ngul, sjell, mbledh, bluaj* etj. me frazeologji të tilla si: **bjen terri** errësohet, ngriset, **baj kuvend** kuvendoj, bisedoj, **iu çel goja** foli, **iu çue malli** u mallua shumë, **lëshoj sytë** vështroj, **s'jep shej** nuk duket a nuk shfaqet etj.

Duhet të përmendim këtu si një veçori njësitë e shumta frazeologjike të këtij tipi të ndërtuara me foljen *qes*: dalin 27 frazeologji të tilla të ndërtuara me këtë folje, karakteristike për gegërishten, si: **qes cekën, e qes maje, i qes gjuhë, i qet kryet tym, ia qes në vesh, e qis mendsh, nuk të qet në va** etj.

Njësitë frazeologjike ndajfoljore vijnë për nga sasia fill pas grupit frazeologjik foljor; kanë dalë 126 frazeologji të tilla, që përbëjnë 17% të gjithë lëndës frazeologjike të vjelë.

Thuajse në mënyrë të barabartë, një pjesë e kësaj frazeologjie ndajfoljore i përket grupit të njësive frazeologjike me lidhje të jashtme

(sintagmatike) të pashprehura, kurse pjesa tjetër grupit të njësive frazeologjike me lidhje të jashtme (sintagmatike) të shprehura⁵.

Në frazeologjitë e grupit të parë dalin njësi nga të dy tipat strukturorë: frazeologji të formuara nga përsëritja e së njëjtës fjalë dhe frazeologji të formuara nga dy fjalë me lidhje kuptimi, të bashkërenditura ose të nënrenditura, si: **mbarë e mbarë, rrugë e mbi rrugë, kic më kic, flakë në flakë, pëllambë për pëllambë, kohë pa kohë, krye në krye, qenë pa qenë, thirrë e pa thirrë, aty për aty, në fund të fundit, lesh e li, nis e sos, kulm e themel, kryq e tërthoras, kodra pas bregut, fill e për pe, me gjak e me laj, pa vend e kohë** etj.

Në frazeologjitë e grupit të dytë dalin njësi frazeologjike të ndërtuara me elemente krahasuese, kryesisht frazeologji që nisin me lidhëzat krahasuese *si* dhe *sa* dhe ndërtime frazeologjike që nisin me parafjalë, si p. sh.: (del) **si kërpudhë pas shiut** (del) menjëherë, **si gjethi i malit** përnjëherë e me shumicë, (humbet) **si vesa para diellit**, (shkyhet) **si krypa në ujë, si mizë për kërcunë** me shumicë, (zhduket) **si shurra e pulës** pa arritur ta shohë njeri, **si pula pa krye, sa hap e çel synin**, (gënjen) **sa ka kryet, me zemër pezull, me zemër në dorë**, (vepron) **me mend në krye** etj.

Në frazeologjitë ndajfoljore dalin edhe njësi të tjera që nuk përbëjnë ndonjë grup, si: (asht ba) **me iu dhimbë gurit e drunit**, (është) **për t'u qa me lot** etj.

Njësitë frazeologjike mbiemërore të përdorura në veprat e mësipërme përbëjnë një grup më të vogël: kanë dalë 52 njësi, të cilat zënë 7% të lëndës së vjelë. Megjithatë këto frazeologji, duke u përdorur si epitete me një ngjyrim të theksuar emocional, shërbejnë veçanërisht si mjete me vlerë stilistike.

Martin Camaj ka përdorur në veprat e veta letrare tipa të ndryshëm strukturorë: njësi që nisim me lidhëzën krahasuese *si*, ndërtime që nisim me parafjalën *me*, ndërtime që përbëhen nga dy folje, njësi frazeologjike me strukturë fjalie etj., si p. sh.: **si kalë shtrigash** me trup të dobët e të shëmtuar **sa i duken kockat, si shiu në verë** shumë i kërkuar, (janë) **si thoni në mish** shumë të lidhur; **me frigë në sy** i frikësuar, **me zemër ari** shpirtmirë e bujar, (është) **me mend në krye** i zgjuar, i pjekur e i matur; (është) **qesh e ngjesh** thumbues; **ka pikë prej qielli** (kryesisht për vajza e gra) shumë e bukur, **e ka harrue vdekja** shumë plak, sa nuk mbahet mend kur ka lindur etj.

⁵ Ky grupim është bërë sipas klasifikimit të Jani Thomait në “Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe”, Tiranë 1981, f. 129.

Veçojmë këtu njësitë frazeologjike mbiemërore, që kanë si gjymtyrë të parë një mbiemër prejppjesor e si gjymtyrë të dytë një emër, të cilat vijnë nga togjet frazeologjike foljore gjegjëse, si: **i dalun hatullash** “i çmendur” nga **ka dalë hatullash** është çmendur.

Përdorimi i frazeologjive të këtij tipi strukturor nga autori përbën vërtet një prirje. Këtë e tregojnë rastet e shumta të përdorura në veprat e vjela, që në raport me gjithë lëndën frazeologjike mbiemërore përbëjnë 25% të frazeologjive mbiemërore, si: **i lëshuem zemre** shumë i dëshpëruar, që nuk e mban veten fare, **i bamë kular** shumë i përkulur a i kërrusur, **i ndërruem orësh** i çmendur, **i ndryshkun mendsh** i matufosur, **i lëshuem fuqish** shumë i lodhur, **i frymë brinjësh** (nga të ngrënë të shumtë) shumë i ngopur, **i cokatun në krye** i çmendur etj.

Këto njësi jo vetëm përmirësojnë më tej strukturën sinonimike të frazeologjisë, por pasurojnë edhe vargun modelor çerdhor “frazeologji foljore – frazeologji mbiemërore me pjesore”, duke e mbështetur konceptin e modelimit në frazeologji, edhe pse jo me statusin që ka ai për leksikun.

Frazeologjitë emërore dhe përemërore të përdorura nga Camaj janë shumë të pakta, 18 njësi (14 emërore e 4 përemërore), që përbëjnë 2% të gjithë lëndës, prandaj nuk po ndalemi fare.

Pasurinë e madhe frazeologjike të gjuhës së Camajt e dëshmojnë jo vetëm frazeologjitë e shumta, për të cilat kumtuam më lart, por edhe nuancat kuptimore të reja që hasen në shumë frazeologji të njohura, që mbartin në përmbajtjen e vet edhe frazeologji të njohura. Çdo kuptim tjetër që i shtohet strukturës kuptimore të një frazeologjie në një farë mënyre është një frazeologji e re. Dhe kuptime të tilla, që e zgjerojnë përmbajtjen kuptimore të njësive frazeologjike, dalin shumë në materialin e vjelë. Frazeologjia **ia marr anën** p.sh., përdorur gjerësisht duke iu referuar diçkaje, me kuptimin “fitoj njohuritë e shprehitë e nevojshme për të bërë një punë etj.” në roman del, duke iu referuar dikujt, me kuptimin “i shmangem” (Drenashi u kujtue se ishte vonë që t’i merrte anën, sepse Baci e kishte pa maparë dhe kish zanë shtegun në pritje që fetari të avitje. M.C., Rrathët, f. 13). Po ashtu, frazeologjia **e qis mendsh** (dikë), që përdoret gjerësisht në arealin e gegërishtes me kuptimin “e çmend”, te Camaj haset me kuptimin “e lë në harresë, nuk kujtohem për të” (... edhe fyemja se të gjithë bota e kishte qit mendsh punën e tij, e largonte shoqnisë. M.C. Rrathët, f. 296).

Gjuha e Camajt dallohet edhe për një pasuri të begatë njësish frazeologjike që futen në lidhje sinonimie, si sinonime të mirëfillta a si variante sinonimike në çifte a vargje me gjegjëset e tjera sinonimike të shqipes duke pasuruar kështu vargjet sinonimike përkatëse e duke

përmirësuar kështu më tej strukturën sinonimike të gjuhës shqipe. Mund të përmendim njësi të tilla, si: **vë kambën** krahas me *ngul këmbë*, **tret frymën kot** / *humbet (harxhon) frymën kot*, **më shtjerret (më prishet) zani** / *më ngjiret zëri*, **heq të zitë e thonit** / *heq të zitë e ullirit*, **pa i ra synit me qepallë** / *pa iu dridhë qepalla (qerpiku syri)*, **kthehem në vete** / *vij në vete*, **i kcejnë rebet** / *i hipin xhindet (qipujt)*, **e shtie dreqin në kungull** / *e shtie dreqin (shejtanin) në shishe*, **e marr në hiri** / *e marr për zemër*, **më hyn në zemër**, **si gjylpana në miell** / *si gjilpëra në kashtë*, **si kamba qelbin** / *si plaga qelbin*, **me mend majë kësule** / *me mend majë koke*, **kthen tallaganin sipas motit** / *kthen gunën nga fryn era* etj.

Këtë pasuri frazeologjike sinonimike Camaj e përdor dendur për efekte stilistike duke shfrytëzuar te sinonimet jo vetëm atë që i afron, por edhe atë që i dallon njëri nga tjetri. Në vargjet e mëposhtme shprehet: “Zade, moj vashë, buza mua shqim m’a terë / ... Zade, moj Zade, gjuha shqim m’a rreshkë.” (M.C., VL 2, f. 28). Të dyja frazeologjitë: “m’a terë buza” dhe “m’a rreshkë gjuha” kanë kuptimin “kam shumë etje”. Me anë të tyre shmanj përsëritjen dhe jep të shkallëzuar tiparin e veprimit. Foljet *teret* dhe *rreshket*, që mbartin në frazeologjitë përkatëse edhe vatrën kuptimore, edhe atë gramatikore, kanë dallime kuptimore: *teret* “thahet”, *rreshket* “thahet derisa rrudhet”, pra me shkallëzim në intensitetin e veprimit që autori e realizon në poezi nëpërmjet renditjes së vargjeve.

Këtë frazeologji të pasur Camaj e ka derdhur mjeshtërisht në krijimtarinë e vet, duke treguar kujdes për përdorimin dhe përfshirjen në kontekst të çdo njësie frazeologjike.

Në përdorimin e njësive frazeologjike, mund të përmendim si veçori rastet jo fort të rralla të përqendrimit të disa njësive frazeologjike brenda një fraze të vetme; madje ka raste të tilla kur brenda kësaj fraze janë përdorur deri edhe pesë njësi frazeologjike ose kur fraza është e ndërtuar vetëm me frazeologji, si: “Ky quhej zëvendës, pa shkrim e këndim, por ishte një asish katundarësh që të japin venë pa të kuq, qesin gurin e fshehin dorën, të çojnë te kroi e të kthejnë pa pi dhe s’kapen as për kreje, as për bishi – më sa ngjala.” (M.C., Rrathët), “Pse doni ta bani mizën buall apo për një plesht të digjni jorganin?” (M.C., Rrathët, f. 23).

Lidhur me përfshirjen në kontekst të njësive frazeologjike vihet re kujdesi i veçantë i treguar nga Camaj për sintagmatikën e çdo njësie frazeologjike ose frazematikën, si kontekst i realizimit të kuptimeve të saj, e cila është një tjetër veçori. Për çdo frazeologji të përfshirë në kontekst janë ruajtur të dyja elementet themelore të lidhura ngushtë njëri me tjetrin: përmbajtja e njësisë frazeologjike, e lidhur me domethënien e kontekstit, dhe forma e saj e cila në këtë përfshirje i nënshtrohet pa dyshim të gjitha

kërkesave morfo-sintaksore të lidhjes së frazeologjisë me gjymtyrë të tjera në fjali. Nëpërmjet lidhjeve të qarta e të përpikta sintagmatike të njësive të përfshira në kontekst, Camaj ka arritur të shprehë saktësisht si kuptimet e nuancat kuptimore të njësive frazeologjike, ashtu edhe vlerat mbishtresore të tyre. Kur e ka ndier se në ndonjë frazeologji kuptimi a nuanca nuk është e shprehur qartë, sepse njësia frazeologjike a një gjymtyrë e saj është pak e njohur për lexuesin, vë në kontekst një fjalë, një tog, një fjali ose edhe një frazeologji si shtjellim kuptimor. Po e ilustron vetëm me një shembull: “Rapsodi ishte në krahësim me banorët e asaj ane i shkurtë e i thamë, ’ në mish të vet’, e kundërta e njeriut në’ mish të huej’, domethanë të njeriut të frytë si Baci.” (M.C. Rrathët, f. 118).

Po lidhur me përfshirjen në kontekst të njësive frazeologjike, përmendim edhe një veçori tjetër: modifikimet e ndryshme që herë-herë njësive frazeologjike, si: ndërrimi rendit të gjymtyrëve (inversioni), ndërputja e fjalëve të tjera, zgjerimi a cungimi i njësisë frazeologjike, pa e shpërbërë atë, dhe kthimi formal i trajtës mohuese duke ruajtur përmbajtjen mohuese të saj: “... këtu në Ripë më kanë dërgue për të krye detyra të kapshme dhe jo për të qitë shkarravina mbi besëtytni e trillime ndërgjegjesh të smura dhe të hyj në rigatën e rrymave letrare dekadente e pa perspektivë. Në aso dërrasash të kalbëta nuk shkel unë!” (M.C. Rrathët, f. 179). Siç shihet, brenda një frazeologjie Camaj ka bërë tri modifikime për efekte stilistike.

Gjithë këtë pasuri frazeologjike Martin Camaj jo vetëm e njohu thellë dhe e përdori saktë, por diti edhe ta modifikojë në tekst për ta futur në letërsi me të gjitha vlerat dhe valencat që mbart; mbetet t’i shtohet si bukuri mbarë shqipes.

